



British Embassy
Pristina



SHKOLLAT ME MË PAK NXËNËS

DOKUMENT I POLITIKAVE

MARS 2020, PRISHTINË



SHKOLLAT ME MË PAK NXËNËS

DOKUMENT I POLITIKAVE

MARS 2020, PRISHTINË

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
SFONDI	7
Politikat/legjislacioni për arsimin në Kosovë.....	
KONTEKSTI I POLITIKAVE: BASHKIMI I SHKOLLAVE	8
REZULTATET DHE ANALIZA	10
Fokus grupet.....	17
REKOMANDIME PËR POLITIKA ARSIMORE	18
REFERENCAT	20

TABELAT

Tabela 1: Llogaritja e të njëjtës gjeneratë në periudhën trevjeçare, Statistikat e Arsimit në Kosovë (MASHT dhe ASK).	11
Tabela 2: Raporti mësimdhënës/nxënës, të dhënat individuale nga drejtoritë e arsimit në secilën komunë	16

GRAFIKËT

Grafiku 1: Numri i shkollave gjatë viteve shkollore 2016/17, 2017/18, 2018/19, Statistikat e Arsimit në Kosovë (MASHT dhe ASK).	12
Grafiku 2: Numri i mësimdhënësve gjatë viteve shkollore 2016/17, 2017/18, 2018/19, Statistikat e Arsimit në Kosovë (MASHT dhe ASK).....	13
Grafiku 3: Shkollat me numër më të vogël të nxënësve, të dhënat individuale nga drejtoritë për arsim në secilën komunë.....	14

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materiale që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

AUTOR: Gresa Statovci, Master i Politikave Arsimore për KDI

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Projekti “Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale” realizohet me fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës KDI dhe hulumtueses dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas valës së fundit të migrimit dhe emigrimit, Kosova po përballët me sfidën e funksionimit të shkollave me një numër gjithnjë e më të vogël të nxënësve. Shkollat po bëhen më të zbrazëta, veçanërisht në zonat rurale. Gjatë tri viteve të fundit, rreth 17.669 nxënës kanë braktisur shkollat, ndërsa numri i institucioneve arsimore dhe mësimdhënësve ka mbetur afërsisht i njëjtë. Pas këtij trendi, hartuesit e politikave duhet të vazhdojnë të zhvillojnë politika të qëndrueshme dhe të zbatueshme arsimore për të rritur cilësinë dhe efikasitetin në sistemin arsimor në Kosovë.

Si politikë e mundshme arsimore për ta trajtuar këtë çështje konsiderohet bashkimi/fuzionimi i shkollave. Sipas shteteve të zhvilluara, avantazhet e kësaj politike janë: kursim i shpenzimeve, mw shumë zgjidhje dhe shumëllojshmëri e programeve akademike, aktivitete jashtëkurrikulare, objekte më të mira mësimore, trajnime profesionale për mësimdhënësit, ambient më i përshtatshëm për nxënësit me nevoja të veçanta. Ndërsa, disavantazhet e kësaj politike janë: rritje e kostove të transportit për nxënësit dhe për stafin e zhvendosur, rritje e shkallës së braktisjes së shkollës, ulje e përfshirjes së prindërve në aktivitetet shkollore dhe shoqërore, përkeqësim i shërbimeve lokale, zvogëlim i mundësisë për përzgjedhjen e shkollës dhe ndikime negative shoqërore dhe emocionale, përfshirë bulizmin, posaçërisht për nxënësit që janë në disavantazh në aspektin socio-ekonomik.

Kjo analizë e shkurtër për politika publike inkurajon Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të hartojë një plan strategjik kombëtar duke marrë mbështetjen e prindërve dhe të komunitetit për çdo veprim. Kjo përmbledhje propozon këto rekomandime të politikave arsimore:

- Të ristrukturohen/rimodelohen shkollat e shpopulluara për t'i përmbushur nevojat e komunitetit dhe të nxënësve duke rialokuar buxhetin e dedikuar për këto shkolla përmes bashkimit/fuzionimit të tyre.
- Të hartohet dhe nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi në mesin e të gjithë mësimdhënësve nga e njëjta komunë për ta ristrukturuar personelin.
- Të sigurohen kushte të përshtatshme dhe mbështetje për të gjithë nxënësit që zhvendosen në një shkollë me numër më të madh nxënësish, përfshirë (1) transportin efikas, (2) kujdesin nga prindërit/komuniteti gjatë transportit, (3) ofrimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare.
- Të sigurohet mbështetje psikologjike për nxënësit në shkollat e konsoliduara me qëllim që të lehtësohet procesi i tranzicionit dhe të shmangët ngacmimi (bullizmi).
- Të sigurohet vëmendje e veçantë dhe mbështetje financiare për shkollat në zonat malore ku transporti është pothuajse i pamundur, veçanërisht gjatë dimrit, dhe këto shkolla të trajtohen si rast i veçantë në këtë politikë.

SFONDI

POLITIKAT/LEGJISLACIONI PËR ARSIMIN NË KOSOVË

Relevante për shkollat me numër më të vogël nxënësish

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës¹ rregullon të gjitha aspektet e arsimit parauniversitar. Në këtë ligj, Neni 7 - Kompetencat e komunave, neni 15 - Vijueshmëria në shkollë dhe neni 28 - Financimi janë nenet kryesore që shërbejnë si bazë ligjore për trajtimin e shkollave me numër më të vogël nxënësish. Neni 7 i bën komunat përgjegjëse për t'i mirëmbajtur dhe për t'i riparuar institucionet arsimore dhe për të siguruar një mjedis të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin përmes financimit të tyre. Për më tepër, neni 28 specifikon formulën e financimit për shkollat dhe, si përmbledhje, financat lidhen shumë me numrin e nxënësve pasi ato shpërndahen kryesisht bazuar në regjistrimin e nxënësve, raportin nxënës-mësimdhënës, llojin dhe madhësinë e objekteve, dhe financimin për nxënës për shpenzime operative dhe investime kapitale. Për më tepër, ligji parasheh financim të veçantë për shkollat në zona të thella malore. Objektet arsimore publike ndërtohen dhe financohen përmes buxhetit të komunës dhe përmes donacioneve tjera.²

Krahas ligjit për arsimin parauniversitar, Udhëzimi Administrativ (UA) Nr.22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës rregullon numrin e nxënësve për klasë dhe duhet të përdoret si

bazë për t'i ristrukturuar shkollat me numër më të vogël nxënësish. Ky UA specifikon që për nivelin e parë të shkolimit – klasat 1-5 – një klasë duhet të ketë rreth 30 nxënës ose maksimum 35; ndërsa, raporti mësimdhënës-nxënës duhet të jetë 1:21.3. Në nivelin e dytë dhe atë të tretë – klasat 6-12 – klasat duhet të ketë 32 nxënës ose maksimum 35; dhe raporti mësimdhënës-nxënës është 1:21.3. Për shkollat në zonat malore (700 metra ose më tepër të lartësisë mbidetare), raporti mësimdhënës-nxënës duhet të jetë 1:14.3.³ Për më tepër, UA për Planifikimin e Investimeve Kapitale, në nenin 3, thotë se kriteret për rinovimin e shkollave fillore dhe atyre të mesme gjithashtu bazohen dhe i japin përparësi numrit të nxënësve për shkollë. Kështu shkolla duhet të ketë së paku 210 nxënës që të kualifikohet për rinovim.⁴ Nëse shkollat bashkohen për shkak të mungesës së financimit, ose nëse shkollat nuk janë të qasshme për nxënësit në atë zonë, neni 15 i Ligjit për Arsimin parauniversitar i obligon komunat të organizojnë transport të sigurt dhe efikas për nxënësit që jetojnë të paktën 4 km larg shkollës, për të promovuar vijueshmërinë në shkollë dhe për të ulur nivelet e braktisjes së shkollës në arsimin e detyrueshëm.

¹ Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

² Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

³ Udhëzimi Administrativ për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10018>

⁴ UA për Planifikimin e Investimeve Kapitale: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/ua-masht-04-18-per-planifikimin-e-investimeve-kapitale.pdf>

KONTEKSTI I POLITIKAVE: BASHKIMI I SHKOLLAVE

RASTE NGA SHTETET E ZHVILLUARA DHE FQINJE

Çështja e ndryshimit të demografisë po prek shkollat në të gjithë botën dhe kjo gjë ka kërkuar organizim efektiv të shkollave. Shtetet e zhvilluara kanë zgjedhur bashkimin e shkollave - mbylljen dhe shkrirjen e shkollave të vogla në shkolla më të mëdha - si strategji për të kursyer shpenzime dhe për të krijuar një sistem arsimor më të mirë për stafin dhe për nxënësit⁵. Përfitimet nga shkollat e konsoliduara përfshijnë një listë të zgjeruar të programeve akademike, aktivitete jashtëkurrikulare dhe objekte më të mira mësimore.⁶ Për më tepër, mësuesit do të kenë më shumë qasje në burime dhe aktivitete të zhvillimit profesional, dhe nxënësit me nevoja të veçanta mund të marrin gjithashtu mbështetje më të mirë arsimore dhe sociale.⁷ Dëshmitë gjithashtu sugjerojnë që shkollat me kushte jo të mira të punës dhe në lokacione që nuk janë lehtësisht të arritshme – kanë vështirësi në mbajtjen ose rekrutimin e stafit me nivele të dëshirueshme përvoja dhe kualifikimi⁸.

Në anën tjetër, ekzistojnë edhe rreziqe dhe shpenzime që lidhen me bashkimin e shkollave, siç janë rritja e shpenzimeve të transportit për nxënësit dhe për stafin e zhvendosur, rritja e nivelit të braktisjes së shkollës, ulja e përfshirjes së prindërve dhe e jetës sociale, përkeqësimi i shërbimeve lokale, zvogëlimi mundësisë për përzgjedhjen e shkollës dhe shpenzimet e tjera sociale⁹. Bazuar në dëshmi, ndikimi shtesë negativ i mbylljes së shkollave është se nxënësit në situatë më të vështirësuar socio-ekonomike preken më shumë. Ky ndikim negativ do të ishte më i vogël nëse shteti vendosë të ofrojë një shkollë me financim publik brenda një distance të arsyeshme¹⁰.

Para se të marrin ndonjë vendim për bashkimin e shkollave, hartuesit e politikave arsimore duhet ta kryejnë një analizë transparente dhe shteruese të ndikimit që mund të prodhojë bashkimi i shkollave tek nxënësit, familjet dhe komuniteti lokal. Analiza dhe vlerësimi duhet të përfshijnë: aspektet e cilësisë së arsimit dhe arritjet akademike të nxënësve, aranzhimet për transport efikas, përfshirjen

e prindërve, marrëdhëniet shoqërore dhe rezistencën e publikut. Thëks i veçantë duhet t'u jepet këtyre grupeve të interesit – nxënësve, prindërve dhe komunitetit lokal – pasi shkollave u jepet vlerë e lartë shoqërore në secilin komunitet dhe bashkimi i tyre mund të shkaktojë pakënaqësi në publik.¹¹

**SHKOLLAT ME KUSHTE JO
TË MIRA TË PUNËS DHE NË
LOKACIONE QË NUK JANË
LEHTËSISHT TË ARRITSHME
– KANË VËSHTIRËSI NË
MBAJTJEN OSE REKRUTIMIN
E STAFIT ME NIVELE TË
DËSHIRUESHME PËRVOJE DHE
KUALIFIKIMI.**

5 Echazarra, A dhe Radinger, T. (2019). Learning in Rural Schools: Insights from Pisa, Talis and the Literature (shqip: Të mësuarit në shkollat rurale: vështirime nga Pisa, Talis dhe literatura).

6 Rogers, J., T. Glesner dhe H. Meyers (2014), "Early experiences implementing voluntary school district mergers in Vermont" (shqip: Përvojat e hershme në zbatimin e bashkimeve vullnetare të shkollave të garkut në Vermont).

7 Delp, C. (2015), Mount Rogers Combined School: The Experiences and Perspectives of Students and Staff When a Community School Closed (shqip: Shkolla e kombinuar Mount Rogers: Përvojat dhe perspektivat e nxënësve dhe të stafit kur një shkollë komuniteti mbyllet).

8 Guarino, C., L. Santibañez dhe G. Daley (2006); shih gjithashtu: Loeb, S., D. Kalogrides dhe E. Horng (2010); Johnson, S., M. Kraft dhe J. Papay (2012); Goldhaber, D., L. Lavery dhe R. Theobald (2015).

9 Bushrod, G. (1999); shih gjithashtu: Schafft, K. (2016); Semke, C. dhe S. Sheridan (2012); Valencia, R. (1985).

10 Gronberg, T. et al. (2005); shih gjithashtu: Schafft, K. (2016); Witten, K. et al. (2001).

11 Echazarra, A and Radinger, T. (2019). Learning in Rural Schools: Insights from Pisa, Talis and the Literature (shqip: Të mësuarit në shkollat rurale: vështirime nga Pisa, Talis dhe literatura).

REZULTATET DHE ANALIZA

KOSOVË

Hartuesit dhe zbatuesit e politikave arsimore në Kosovë duhet të drejtojnë fokusin e tyre në shkollat e shpopuluara për t’iu përshtatur tendencave aktuale të migrimit dhe emigrimit. Gjatë tri viteve të fundit, përmes krahasimit të viteve shkollore 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 vëre-

jmë se 17.669 nxënës janë larguar nga Kosova. Siç tregon tabela 1, rezultatet llogariten vetëm ndërmjet të njëjtave gjenerata në periudhën trevjeçare – 17.669 nxënës që ishin në klasat 1 deri në 10 në vitin shkollor 2016/17 nuk kanë vazhduar shkollimin e tyre në dy vitet pasuese.

VITEVE SHKOLLORE 2016/17,
2017/18 DHE 2018/19
VËREJME SE 17.669 NXËNËS
JANË LARGUAR NGA KOSOVA.
KLASAT 1 DERI NË 10 NË VITIN
SHKOLLOR 2016/17 NUK KANË
VAZHDUAR SHKOLLIMIN E
TYRE NË DY VITET PASUESE.

KLASA	2019	2018	2017
1	27,426	26,844	26,681
2	25,998	26,004	26,486
3	25,422	26,185	26,501
4	25,709	26,379	26,182
5	25,800	26,041	26,588
6	25,675	26,322	27,342
7	25,689	27,004	28,198
8	26,526	27,761	28,936
9	26,916	28,242	30,910
10	26,635	29,704	32,577
11	26,563	29,272	29,679
12	27,797	27,786	24,152
TOTAL	316,156	327,544	334,232


TABELA 1: Llogaritja e numrit të nxënësve të së njëjtës gjeneratë në periudhën trevjeçare, Statistikat e Arsimit në Kosovë (MASHT dhe ASK).

Përkundër shpopullimit të shkollave, numri i institucioneve arsimore nuk ka ndryshuar ndjeshëm, apo fare. Duke iu referuar grafikut 1, dy shkolla të reja fillore/të mesme të ulëta u hapën për vitin shkollor 2017/18, dhe gjashtë shkolla të të njëjtit nivel u mbyllën në vitin pasues. Ndërsa, gjashtë shkolla të mesme të larta u hapën gjatë vitit

shkollor 2018/19 në krahasim me vitin shkollor 2016/17. Numri i institucioneve parashkollore mbeti i njëjtë gjatë kësaj periudhe kohore.



INSTITUCIONET SHKOLLORE SIPAS NIVELEVE




● Parashkollor/Çerdhe ● Fillor dhe i mesëm i ulët ● I mesëm i lartë

GRAFIKU 1:

Numri i shkollave gjatë viteve shkollore 2016/17, 2017/18, 2018/19, Statistikat e Arsimit në Kosovë (MASHT dhe ASK).



NUMRI I MËSIMDHËNËSVE NË 3 VITET E FUNDIT



GRAFIKU 2:

Numri i mësimitdhënësve gjatë viteve shkollore 2016/17, 2017/18, 2018/19, Statistikat e Arsimit në Kosovë (MASHT dhe ASK).

Përveç ndryshimeve të papërfillshme në numrin e shkollave, as numri i mësuesve nuk ka ndryshuar, pavarësisht shpopullimit të shkollave. Siç tregon grafiku 2, 79 mësues u punësuan dhe iu bashkuan institucioneve arsimore të Kosovës gjatë vitit shkollor 2017/18. 19 mësimitdhënës u larguan nga sistemi arsimor në vitin shkollor 2018/19.


Si përmblendhje, edhe pse 17.669 nxënës nuk kanë vazhduar shkollimin në Kosovë nga viti shkollor 2016/17 deri në vitin shkollor 2018/19, gjatë kësaj periudhe trevjeçare janë punësuar 60 mësimdhënës shtesë, janë hapur 6 shkolla të mesme të larta dhe janë mbyllur 6 shkolla fillore/të mesme të ulëta (duke llogaritur 2 shkollat e reja në vitin shkollor

2017/18). Shkollat e reja u hapën në Ferizaj, Gjiilan, Glogovc, Lipjan dhe Novobërdë - Gjilani dhe Lipjani janë dy nga komunat me përqindjen më të lartë të shkollave me numër më të vogël të nxënësve (shih grafikun 3 më poshtë). Duke marrë parasysh këtë mospërputhje midis numrit të nxënësve, të shkollave dhe të mësimdhënësve, MASHT-i, si organi rregul-

lator i sistemit arsimor në Kosovë, duhet të fillojë hartimin e politikave arsimore të cilat përkohë me gjendjen aktuale të secilës komunë dhe synojnë rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit arsimor në Kosovë.

Sot, të gjitha komunat në Kosovë, diku më pak e diku më shumë janë të afektuara nga rënia e numrit të nxënësve në shkolla. Për të krijuar një pamje më të individualizuar të gjendjes aktuale në secilën prej komunave në Kosovë,

KDI përmes drejtorive për arsim ka mbledhur të dhënat nga secila komunë për numrin e nxënësve dhe të mësimdhënësve për secilën shkollë. Të dhënat nga grafiku 3 tregojnë komunat me përqindjen më të lartë të shkollave që kanë më pak se 50 nxënës krahasuar me gjithsej numrin e shkollave në komunë. Dragashi, Gjilani, Kamenica, Lipjani, Istogu dhe Mitrovica kanë përqindjen më të lartë të shkollave me numër më të vogël të nxënësve.



GRAFIKU 3:

Shkollat me numër më të vogël të nxënësve, të dhënat individuale nga drejtoritë për arsim në secilën komunë.

● Numri i Shkollave

● Numri i shkollave me pak nxënës

● % e shkollave me pak nxënës

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga secila komunë ku të dhënat janë në dispozicion, raporti mësimdhënës/nxënës është llogaritur ashtu siç tregohet në tabelën 2. Megjithëse UA për raportin mësimdhënës/nxënës specifikon që ky raport duhet të jetë mesatarisht 1:21 apo 1:14 në

zonat malore, në Kosovë megjithatë ka raste kur raporti mësimdhënës/nxënës është 1:0.5, prandaj, duke u bazuar në tabelën 2, raporti i specifikuar në UA në këto shkolla me numër më të vogël të nxënësve nuk përmbushet.

Komuna	Nxënës/Mësimdhënës	Komuna	Nxënës/Mësimdhënës
Lipjan	3.3	Mitrovicë	0.5
Lipjan	4.0	Mitrovicë	0.8
Lipjan	5.0	Mitrovicë	1.5
Lipjan	7.0	Mitrovicë	2.7
Lipjan	7.0	Prishtine	1.0
Lipjan	7.5	Prishtine	1.0
Lipjan	8.0	Prishtine	1.1
Lipjan	8.0	Prishtine	2.3
Lipjan	8.5	Prishtine	2.5
Lipjan	8.5	Prishtine	3.0
Lipjan	9.0	Prishtine	5.9
Lipjan	9.0	Viti	0.5
Lipjan	10.0	Viti	2.7
Lipjan	10.5	Viti	3.0
Lipjan	11.0	Viti	4.3
Lipjan	11.7	Viti	5.7
Lipjan	14.5	Viti	6.7
Lipjan	19.0	Vushtrri	1.7
Skenderaj	0.6	Vushtrri	4.2

TABELA 2: Raporti mësimdhënës/nxënës, të dhënat individuale nga drejtoritë e arsimit në secilën komunë.

FOKUS GRUPET

Për të kuptuar më mirë gjenezën e sfidave që përcjellin ristrukturimin e shkollave me numër më të vogël të nxënësve që vijnë drejtpërdrejt nga probleme reale në terren, KDI ka organizuar fokus grupet¹² që përbëhen nga kryetarët e komunave, drejtorët e arsimit dhe përfaqësuesit e shkollave nga komunat me përqindjen më të lartë të shkollave me numër më të vogël të nxënësve (shih grafikun 3). Sfidat e identifikuara në fokus grupe të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave arsimore për trajtimin e çështjes së shkollave me numër më të vogël të nxënësve janë:

1. Koncepti i vlerës që i jepet objekteve shkollore. Historikisht, shkollat në Kosovë konsiderohen objekte me shumë me vlerë për komunitetin sepse i kanë dhënë frymë komunitetit. Pikërisht për këtë, ideja e bashkimit të shkollave, që nënkupton edhe mbylljen e shkollave mund të prodhojë kundërshtime dhe pakënaqësi në komunitet. Si zgjidhje e mundshme është shqyrtuar ridizajnimi i objekteve shkollore në objekte për qëllime të tjera që i përmbushin nevojat e komunitetit. Shkolla shihet si objekt që mban komunitetin të lidhur për fshatin dhe frenon shpopullimin e tij. Konsolidimi i shkollave, do të promovonte zhvendosjen e popullsisë në zonat urbane por edhe jashtë shtetit. Hartuesit dhe zbatuesit e politikave arsimore duhet të bindin dhe sigurojnë komunitetet që shkollat nuk janë duke u mbyllur por duke u ristrukturuar në mënyrë që të kenë përdorim alternativ dhe efikas, gjithnjë në shërbim të nevojave të komunitetit. Për më tepër, ato duhet të ridestinohen në objekte vibrante e me qëllime alternative që do të promovonin moslargimin e popullsisë si p.sh. si qendra të trajnimit, qendra rekreative, institucione parashkollore, qendra kulturore etj. Këto vendime duhet të merren duke u bazuar në nevojat e komunitetit përkatës pas hulumtimit të thellë të tregut në secilën zonë.

2. Mospranueshmëria shoqërore e largimit të mundshëm nga puna të mësimdhënësve në rast të ristrukturimit apo bashkimit të shkollave. Këto komunitete janë shumë të lidhura dhe është për ta, është e papranueshme për ta ideja e largimit nga puna të mësimdhënësve – që janë anëtarë të komunitetit të tyre të ngushtë – të cilët kanë ofruar shërbime në arsim. Për më tepër, gjetja e një vendi të ri të punës në zonat rurale është pothuajse e pamundur për shkak të gjendjes së përgjithshme ekonomike të vendit. Megjithatë, nëse objektet shkollore ristrukturohen ashtu që të përmbushin nevojat e komunitetit, atëherë ato mund të gjenerojnë mundësi të punësimit për komunitetin. Për shembull, nëse shkolla rimodelohet në një qendër të re trajnimi për korrjet, ajo qendër do ketë nevojë për një zyre administrative dhe ekzekutive.

3. Rritja potenciale e cilësisë së arsimit, në rast të ristrukturimit apo bashkimit. Ekziston një dakordim i përbashkët që cilësia e arsimit mund të jetë më e mirë në shkollat me numër më të madh të nxënësve meqenëse ato ofrojnë më shumë mundësi dhe qasje në burime për nxënësit dhe mësimdhënësit. Gjithashtu, ka më shumë investime në shkollat me numër më të madh të nxënësve pasi që paraja publike i “ndjek” nxënësit.

4. Vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet shkollave në viset malore meqenëse transporti gjatë dimrit është i pamundshëm pas analizës. Edhe me një shërbim shumë efikas të transportit për nxënës që ata të vijnë shkollimin në shkollat me numër më të madh të nxënësve, transporti nga viset malore është gati se i pamundshëm gjatë dimrit, prandaj hartuesit e politikave duhet ta kenë këtë parasysh gjatë hartimit të politikave në lidhje me këtë dhe rrjedhimisht të vendoset nëse këto shkolla duhet të bashkohen.

12 Pjesë e fokus grupeve kanë qenë 27 përfaqësues, 5 mars 2020.

REKOMANDIME PËR POLITIKA ARSIMORE

Meqenëse shpopullimi i shkollave ndikon në komunat e Kosovës, veçanërisht në cilësinë arsimore dhe në resurse shkollore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të shqyrtojë hartimin e një strategjie kombëtare të qëndrueshme dhe zbatueshme për ristrukturimin e shkollave, të adaptueshme me specifikat e komunave, që të sigurojë cilësinë e arsimit si dhe institucione të përshtatshme arsimore. Kjo strategji duhet të hartohet me përfshirje të të gjitha grupeve të interesit, me theks të veçantë të prindërve, nxënësve, personelit të shkollave, ekspertëve të fushës, institucioneve lokale e qendrore dhe komunitetit.

Rekomandimet për politika që duhet shqyrtuar gjatë ristrukturimit të shkollave me numër më të vogël të nxënësve përfshijnë:

- **Të ristrukturohen/rimodelohen shkollat e shpopulluara për t'i përmbushur nevojat e komunitetit dhe të nxënësve duke rialokuar buxhetin e dedikuar për këto shkolla përmes bashkimit/fuzionimit të tyre.** Para zhvillimit të një politike të rere arsimore që do t'a adresonte këtë problematikë, hartuesit e politikave duhet të marrin parasysh vlerën që secili objekt shkollor ka për komunitetin si dhe të gjejnë qasjen e duhur për ruajtjen dhe kultivimin e kësaj vlere. Hartuesit e politikave duke u bazuar në hulumtimin e nevojave të komunitetit duhet të arrijnë një marrëveshje të ndërsjellë me prindërit dhe komunitetin për ridestininimin e objektit shkollor.

Për shembull, nëse komuniteti ka nevojë për një qendër parashkollore apo rekreative, objekti aktual shkollor duhet të rimodelohet që të përmbushë atë nevojë. Këto objekte do të financohen nga rialokimi prej secilës komunë nga kostot operative të objektit shkollor dhe donacionet shtesë për investime kapitale.

- **Të hartohet dhe nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi në mesin e të gjithë mësimdhënësve nga e njëjta komunë për ta ristrukturuar personelin.** Me qëllim që të shmanget pakënaqësia dhe revoltimi i komunitetit si rezultat i humbjeve potenciale të vendeve të punës së mësimdhënësve, hartuesit e politikave duhet të hartojnë marrëveshje bashkëpunimi në mesin e të gjithë mësimdhënësve nga e njëjta komunë me qëllim që të sigurohet që secili mësimdhënës do të vazhdojë të punojë në sistemin arsimor në Kosovë. Kontratat kolektive mund të përfshijnë (1) mësimdhënien e përbashkët nga mësimdhënësit e të njëjtës fushë, ku orët mësimore dhe detyrat ndahen në mënyrë të barabartë mes mësimdhënësve; apo (2) programe të mentorimit/të mentoruarit, ku mësimdhënësit me më shumë përvojë shërbejnë si mentorë për mësimdhënësit e rinj deri në pensionim. Pagat e të gjithë mësimdhënësve do të mbeten të njëjta apo nuk mund të jenë nën 70% të pagës së përgjithshme – e rregulluar sipas Kontratës

Kolektive të Arsimit në Kosovë¹³, varësisht nga niveli i angazhimit dhe raportit mësimdhënës/nxënës.

- **Të sigurohen kushte të përshtatshme dhe mbështetje për të gjithë nxënësit që zhvendosen në një shkollë me numër më të madh nxënësish, përfshirë (1) transportin efikas, (2) kujdesin nga prindërit/komuniteti gjatë transportit, (3) ofrimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare.** Komuna duhet të ofrojë transport efikas që i përmbush nevojat e orarit të secilit nxënës me qëllim që të shmanget shtimi i kohës së pritjes së nxënësve. Nëse pritja është e pashmangshme, komuna duhet të ofrojë aktivitete jashtëkurrikulare – orë mësimore të gjuhës angleze, të sportit, të artit – apo një klasë të ndarë me mbikëqyrje për detyra të shtëpisë, me qëllim që të mbulohet koha e pritjes për nxënësit të cilët ndikohen nga kjo. Për më tepër, që të lehtësohet përvoja e udhëtimit nga shtëpia në shkollë, komuna duhet të ofrojë mbështetje emocionale për nxënësit duke iu kërkuar anëtarëve të familjes që t'i shoqërojnë nxënësit gjatë udhëtimit apo të caktojnë një mbikëqyrës për secilin autobus.
- **Të ofrohet mbështetje psikologjike për nxënësit në shkollat e bashkuara me qëllim që të lehtësohet procesi i tranzicionit dhe të shmanget ngacmimi (bulizmi).** Secila shkollë duhet të ketë një psikolog që do të trajtojë me përkushtim në nxënësit që kanë ardhur nga shkollat e bashkuara dhe t'i ndihmojë të njëjtit në procesin e tranzicionit. Duke marrë parasysh që nxënësit e transferuar që vijnë nga një status më i ulët socio-ekonomik janë më të prirë të jenë objekt bullizmi, secila shkollë duhet t'i ndërgjeg-

jësojë nxënësit në lidhje me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që përfaqon diversitetin.

- **Të sigurohet vëmendje e veçantë dhe mbështetje financiare për shkollat në zonat malore ku transporti është pothuajse i pamundur, veçanërisht gjatë dimrit, dhe këto shkolla të trajtohen si rast i veçantë në këtë politikë.** Hartuesit e politikave duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zonave malore ku transporti dhe bashkimi i shkollave është gati se i pamundshëm. Në këtë rast, politikëbërësit duhet të vendosin nëse fuzionimi i këtyre shkollave është i përshatshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit, dhe nëse cenon vijueshmërinë në shkollë. Nëse nga kjo analizë vlerësohet që shkolla nuk duhet të bashkohet me shkollë tjetër, **këtyre shkollave në zonat malore** duhet t'u ofrohet **më shumë mbështetje në burime dhe trajnim për mësimdhënës.** Nëse vlerësohet e kundërta, si opsion i politikave të bashkimit të shkollave në zonat malore, gjatë dimrit, komunat mund të ofrojnë burime që këta nxënës të kenë qasje në mësim të drejtpërdrejt online, nëse transporti nuk është i mundshëm.

13 Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë: <http://www.sbashk-rks.org/kontrata.pdf>

REFERENCAT

- Agjencia e Statistikave të Kosovës: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016/17: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2016-17-shqip.pdf>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/18: <https://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/08/statistikat-e-arsimit-2018-2019.pdf>
- Bushrod, G. (1999), "School closure and its impact on community" (*shqip: Mbyllja e shkollës dhe ndikimi i saj në komunitet*), Universiteti i Michiganit, Ann Arbor, MI.
- Delp, C. (2015), "Mount Rogers Combined School: The Experiences and Perspectives of Students and Staff when a Community School Closed" (*shqip: Shkolla e kombinuar Mount Rogers: Përvojat dhe perspektivat e nxënësve dhe të stafit kur një shkollë komuniteti mbyllet*) - Disertacioni i dorëzuar në fakultetin e Institutit Politeknik të Virxhinias dhe Universitetit Shtetëror, Virginia Tech, <http://hdl.handle.net/10919/73217>
- Echazarra, A dhe Radinger, T. (2019). Learning in Rural Schools: Insights from Pisa, Talis and the Literature (*shqip: Të mësuarit në shkollat rurale: vështrime nga Pisa, Talis dhe literatura*). Dokument pune i OECD-së për arsimin: [http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/WKP\(2019\)4&docLanguage=En](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/WKP(2019)4&docLanguage=En)
- Goldhaber, D., L. Lavery dhe R. Theobald (2015), "Uneven playing field? Assessing the teacher quality gap between advantaged and disadvantaged students" (*shqip: Mundësi të pabarabarta? Vlerësimi i hendekut të cilësisë së mësimdhënësve ndërmjet studentëve që janë në avantazh dhe atyre që janë në disavantazh*), Hulumtues arsimor, Vol. 44/5, f. 293-307, <http://dx.doi.org/10.3102/0013189x15592622>
- Gronberg, T. et al. (2005), School outcomes and school costs: A technical supplement prepared for the Texas Joint Select Committee on Public School Finance (*shqip: Arritjet shkollore dhe kostot e shkollës: Shtesë teknike e përgatitur për Komitetin Përbashkët të Përzgjedhur të Teksa-sit për Financat e Shkollave Publike*), The Bush School of Government and Public Service, Universiteti Texas A&M, Stacioni i Kolegjit TX, <http://bush.tamu.edu/research/faculty/TXSchoolFinance>.
- Guarino, C., L. Santibañez dhe G. Daley (2006), "Teacher recruitment and retention: A review of the recent empirical literature" (*shqip: Rekrutimi dhe mbajtja e mësimdhënësve: Përmbledhje e literaturës empirike të kohëve të fundit*), Rishikimi i Hulumtimit Arsimor, Vol. 76/2, f. 173-208, <http://dx.doi.org/10.3102/00346543076002173>
- Johnson, S., M. Kraft dhe J. Papay (2012), "Hoë context matters in high-need schools: The effects of teachers' working conditions on their professional satisfaction and their students' achievement" (*shqip: Rëndësia e kontekstit në shkollat me nevojë të lartë: Efektet e kushteve të punës të mësimdhënësve në kënaqëshmërinë e tyre profesionale dhe në arritjet e nxënësve të tyre*), Regjistrat e kolegjit të mësimdhënësve, Vol. 114/10, f. 1-39
- Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>
- Loeb, S., D. Kalogrides dhe E. Horng (2010), "Principal preferences and the uneven distribution of principals across schools" (*shqip: Preferencat e drejtorëve dhe shpërndarja e pabarabartë e drejtorëve nëpër shkolla*), Vlerësimi arsimor dhe analiza e politikave, Vol. 32/2, f. 205- 229, <http://dx.doi.org/10.3102/0162373710369833>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Kosovës, Udhëzim Administrativ për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10018>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Kosovës. UA për Planifikimin e Investimeve Kapitale: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/ua-masht-04-18-per-planifikimin-e-investimeve-kapitale.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Kosovës. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë: <http://www.sbashk-rks.org/kontrata.pdf>
- Rogers, J., T. Glesner dhe H. Meyers (2014), "Early experiences implementing voluntary school district mergers in Vermont" (*shqip: Përvojat e hershme në zbatimin e bashkimeve vullnetare të shkollave të qarkut në Vermont*), Journal of Research in Rural Education, Vol. 29/7, f. 1-14, <http://jrre.psu.edu>
- Schafft, K. (2016), "Rural education as rural development: Understanding the rural school-community well-being linkage in a 21st-century policy context" (*shqip: Arsimimi rural si zhvillim rural: Të kuptuarit e lidhjes mes shkollës rurale dhe mirëqenies së komunitetit në një kontekst politik të shekullit të 21-të*), Peabody Journal of Education, Vol. 91/2, f. 137-154, <http://dx.doi.org/10.1080/0161956X.2016.1151734>
- Schafft, K. (2016), "Rural education as rural development: Understanding the rural school-community well-being linkage in a 21st-century policy context" (*shqip: Arsimimi rural si zhvillim rural: Të kuptuarit e lidhjes mes shkollës rurale*)



dhe mirëqenies së komunitetit në një kontekst politik të shekullit të 21-të), Peabody Journal of Education, Vol. 91/2, f. 137-154, <http://dx.doi.org/10.1080/0161956X.2016.1151734>

- Semke, C. dhe S. Sheridan (2012), "Family-school connections in rural educational settings: A systematic review of the empirical literature" (*shqip: Lidhjet familje-shkollë në mjediset arsimore rurale: Përmbledhje sistematike e literaturës empirike*), School Community Journal, Vol. 22/1, <http://www.schoolcommunitynetöork.org/SCJ.aspx>
- Valencia, R. (1985), "School closures and policy issues" (*shqip: Mbylljet e shkollave dhe çështjet e politikave*), Public Budgeting & Finance Spring, f. 43-53, <https://doi.org/10.1111/1540-5850.00671>

- Witten, K. et al. (2001), "The impacts of a school closure on neighbourhood social cohesion: narratives from Invercargill, New Zealand" (*shqip: Ndikimet e mbylljes së shkollës në kohezionin social të lagjes: tregime nga Invercargill, Zelandë e Re*), Health & Place, Vol. 7/4, f. 307-317, [http://dx.doi.org/10.1016/S1353-8292\(01\)00023-5](http://dx.doi.org/10.1016/S1353-8292(01)00023-5)

KDI-ja është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni **www.kdi-kosova.org**

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy
Pristina